

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	U siguroi shqiptarëve 20 apartamente për t'i kthyer në 'shtëpi bari', dënohet drejtori i agjencisë imobilare
ADRESA	https://versus.al/aktualitet/u-siguroi-shqiptareve-20-apartamente-per-ti-kthyer-ne-shtepi-bari-den-i46497
BURIMI	versus.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:02:32 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 14:32:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0a3fb1c5755d2fb7b8a919851447dd03901b452c6298fe7a0289f9523adadda8
TEKSTI	617b6cd199a670eda538b8496c4becb3c093bda6212f374000a7b15c40473499
PAMJA	ed0988502e80b6c7a9efce3b8c4313e433dc5e90affef7e9540d2bfff97fec5dc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	87324014633607008d1ee1a3d12bbd8643ef66d19cb19cd510f8a11b7c5b065a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/87324014633607008d1ee1a3d12bbd8643ef66d19cb19cd510f8a11b7c5b065a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[Reforma Territoriale, përplasje mes Ramës dhe aktores Egla Ceno, banorët e Poliçanit bojkotojnë takimin](#)

13 Shtator 2026, 18:17

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në

-
-
-
-
- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [Ekonomi](#)
- [ZANAT](#)
- [VIDEO](#)

- [Politikë](#)
- [aktualitet](#)
- [MAGAZInë](#)
- [bota](#)
- [opinion](#)
- [ekonomi & MJEDIS](#)
- [VIDEO](#)

-
-
-
-

Created and monetized by
[AKTUALITET](#) / 13 Shtator 2026, 16:32

U siguroi shqiptarëve 20 apartamente për t'i kthyer në 'shtëpi bari', dënohet drejtori i agjencisë imobilare



Shkruar nga Versus



Dy prej të dënuarve, drejtori i agjencisë Sarfraz Farooq dhe Uan Gogu

Britani e Madhe- Drejtori i një agjencie imobilare që e përdori biznesin për të gjetur "shtëpi bari" për trafikantët shqiptarë në Angli, është dënuar me 8 vite burg.

Në total pesë persona u dënuan me mbi 14 vite burg pas zbulimit të rrjetit të sofistikuar që drejtohej nga agjencia imobilare "Condor Estates". Hetimi nxori në pah lidhje me kultivimin e kanabisit, kontrata qiraje mashtruese, blerjen e pajisjeve të specializuara hidroponike dhe pastrimin e parave.

Aksioni policor u krye në vitin 2024 në 20 prona; 19 në Luton dhe një në Milton Keynes. Impiante për kultivimin e kanabisit u zbuluan në 19 nga 20 pronat e kontrolluara, ndërsa në pronën e mbetur u gjetën pajisje për rritjen e kanabisit.

Nga pronat u sekuestruan pothuajse 2,000 bimë, me një vlerë deri në 800,000 paund. Vlerësohet se, nëse pronat nuk do të ishin zbuluar, bimët mund të kishin prodhuar kanabis me një vlerë tregu prej më shumë se 2 milionë paundësh brenda vetëm 12 muajve.

Sarfraz Farooq, 46 vjeç, drejtor i "Condor Estates", ishte në krye të rrjetit dhe përgjegjës për një sasi të konsiderueshme dokumentacioni mashtrues, përfshirë dokumentet e përdorura për të krijuar kontrata qiraje false për pronat që përdorehin për kultivimin e kanabisit.

Farooq përdori shtëpi që u përkisnin pronarëve të ligjshëm, të cilët i besuan agjencisë për të dhënë me qira pronat e tyre në mënyrë të rregullt dhe që morën ato që besonin se ishin kontrata qiraje.

Bashkëpunëtori i tij, Uan Gogu, 42 vjeç, luajti një rol qendror në ngritjen e impianteve të kanabisit. Ai përdori prona të lidhura me Farooq-un dhe organizoi instalimin e pajisjeve të specializuara hidroponike. Ai gjithashtu u përfshi në manipulimin e njehsorëve të energjisë elektrike, duke krijuar rreze të konsiderueshme për sigurinë dhe duke shkaktuar zjarre në tri prej pronave.

Të përfshirë ishin gjithashtu Zohaib Riaz Ali, 33 vjeç, i cili ndihmoi operacionin përmes blerjes së pajisjeve hidroponike, ndërsa Mohammed Farooq, 76 vjeç, bleu me para në dorë një pronë që më vonë u zbulua se funksiononte si shtëpi bari. Mes të dënuarve ishte edhe shqiptari Glentjan Sefa, 29 vjeç si pjesë e grupit. **Versus.al**

Tags:

[shtëpi bari](#) [angli](#)

Poll




AKTUALITET

[Dita 106 e revoltës ndaj qeverisë, nga nesër ndryshon orari i protestës](#)

13 Shtator 2026, 20:06

^ekstrakti^





AKTUALITET

["Nuk e di se kush janë hasmit e babait tim", djali i Franc Konomit që u v*a në 2010-ën: Dua të kem mbiemrin e tij](#)

13 Shtator 2026, 18:53

^ekstrakti^



AKTUALITET

["300 mijë € futi tek depozita e gazit", i shkroi letër anonime kushëririt, autori u zbulua nga gabimet gramatikore](#)

13 Shtator 2026, 15:17

^ekstrakti^



AKTUALITET

[Tritoli në Shkodër, autori u maskua si picajol! Dyshohet mesazh kërcënues për vëllain e mësuesit](#)

13 Shtator 2026, 15:04

^ekstrakti^



AKTUALITET

["Larje hesapesh" nga Italia?/ 35 plumba drejt banesës në Mat, Akil Lleshi dyshohet se ishte objektivi i atentatit](#)

13 Shtator 2026, 12:53

^ekstrakti^



AKTUALITET

EMRI/ Operacioni ‘Mesazhi’ në Vorë, kërcënoi kushëririn për t’i marrë 300 mijë €, në pranga 56 vjeçari

13 Shtator 2026, 12:31

^ekstrakti^



AKTUALITET

VIDEO/ Makinat luksoze në “Iupën” e Policisë së Vlorës: Sekuestrohen 3 mjete, nis hetimi ndaj pronarëve

13 Shtator 2026, 12:09

^ekstrakti^



AKTUALITET

“Si në Indi”/ Sportistët europianë denoncojnë kushtet e akomodimit në Tiranë, kritika për organizimin e Kampionatit

13 Shtator 2026, 11:46

^ekstrakti^

Të fundit





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.